

KODI I ETIKËS PËR PUNONJËSIT E OST SH.A**Baza ligjore**

Ky Kod hartohet në zbatim të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe dispozitave ligjore në zbatim të tij.

Neni 1**Qëllimi dhe fusha e veprimit**

1. Qëllimi i këtij Kodi Etike është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për të gjithë punonjësit e OST sh.a, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullat e brendshme të Shoqërisë.
2. Në realizimin e detyrave të tij, punonjësi duhet të respektojë parimet si më poshtë:
 - a. Te arrije ne kohe dhe me perpikmeri objektivat e percaktuara;
 - b. Te mbroje me besnikeri interesat e ligjshme te Shoqerise OST sh.a;
 - c. Te kryeje detyrat e tij funksionale, ne perputhje me rolin e percaktuar ne Shoqeri, duke e perdorur kohen e punes vetem per kete qellim;
 - d. Te veproje ne menyre te pavarur, duke mos penguar zbatimin e politikave te Shoqerise;
 - e. Ne kryerjen e detyrave duhet te jete i ndershem, efikas, duke pasur parasysh vetem interesin e Shoqerise, respektimin e drejtuesve, punonjesve te tjere, shendetin dhe sigurine ne pune;
 - f. Te jete i sjellshem dhe i paanshem ne marredheniet me te tretet;
 - g. Te mos perfitoje ne menyre te padrejte nepermjet manipulimit, fshehjes dhe abuzimit te informacionit qe ka ne dem te nje personi ose shoqerie tjeter;
 - h. Te mos lejoje qe interesat e tij private te bien ndesh me detyrat e tij;
 - i. Te mos kerkoje e as te mos pranoje, nga askush si shperblim para ose sende me vlere, per kryerjen e detyrave te tij;
 - j. Te ruaje konfidencialitetin e informacionit edhe pas largimit nga Shoqeria, sipas percaktimeve ligjore;
 - k. Te raportoje çdo rast vjedhje, shperdorimi, korrupsioni dhe shkelje te rregullave te etikes;
 - l. Te mos beje, pa qene i autorizuar asnje premtim apo pohim dhe as te marre ndonje zotim te çfaredolloji, qe do te implikonte Shoqerine;

- m. Te ndihmoje brenda mundesive te tij, punonjesit e tjere ne rast fatkeqesie, ose rreziku;
- n. Te vere ne dijeni institucionin per çdo ndryshim thelbesor te te dhenave personale qe permban dosja personale e tij;
- o. Te respektoje dhe te zbatoje urdherat dhe udhezimet e pergjithshme dhe te vecanta te eproreve;
- p. Te kryeje komunikim me te tretet, vetem ne rastet kur ka autorizimin paraprak te Administratorit te OST sh.a;
- q. Te respektoje me rigorozitet orarin zyrtar te punes;
- r. Te mbaje nje disipline te larte ne kryerjen e detyrave te tij funksionale;
- s. Të respektojnë marrëdhëniet hierarkike me eprorët, vartësit e kolegët e të njëjtit nivel hierarkik, në funksion të arritjes së qëllimit të realizimit të detyrave dhe mbajtjes së marrëdhënieve korrekte.

Neni 2 Konflikti i interesit

1. Konflikt te interesave do te konsiderohen ato raste kur interesi vetjak i punonjesit, nderhyn ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte, ne interesat e Shoqerise.
2. Interesi vetjak i punonjesit perfshin çdo perparesi ne lidhje me veten, familjen, te afermit deri ne shkalle te dyte, personat ose organizatat me te cilat punonjesi ka ose ka patur marredhenie biznesi ose lidhje politike. Konflikti i interesit perfshin gjithashtu cdo lloj detyrimi financiar ose civil te punonjesit.
3. Punonjesit e OST sh.a duhet te njohin dhe zbatojne me korrektesi detyrimet e kuadrit ligjor qe lidhen me parandalimin e konfliktit te interesit ne ushrimin e detyrave te tyre.
4. Per te shmangur konfliktin e interesit dhe rrezikun e perdorimit te gabuar te informacionit, eshte e nevojshme qe punonjesit te keshillohen me drejtuesit e shoqerise dhe Autoritetin Pergjegjjes per parandalimin e konfliktit te interesave te OST sh.a.
5. Keto raste do te trajtohen sipas ligjit nr. 9367, date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar); ligjit nr. 9049, date 10.04.2003 "Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publike" (i ndryshuar), akteve nenligjore perkatese dale ne zbatim te tyre si dhe rregullores se brendshme te Shoqerise.

Neni 3 Veprimtari te jashtme te punonjesit te Ost sh.a

1. Punonjesi nuk duhet te angazhohet ne nje veprimtari te jashtme qe pengon ne kryerjen e proceseve te tij te punes, pervecse ne ato raste kur kjo eshte percaktuar me

marreveshje te bashkepunimit institucional dhe/ose ne veprimtari te jashtme qe demton imazhin e shoqerise.

2. Punonjesi, per çdo rast te konstatuar ne kundërshtim me sa me sipër, duhet te informoje Drejtorine e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve (DBNJSH).

Neni 4 Veprimtarite e jashtme te lejuara

1. Veprimtarite, ne kuader te veprimtarive sindikale ose te perfaqesimit te punemarresve ose veprimtarite e mesimesdhënie, jane te lejueshme kur ato nuk pengojne ne ushtrimin e detyres.
2. Kryerja e ketyre veprimtarive duhet t'i njoftohet paraprakisht eprorit direkt dhe Drejtorise se Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve (DBNJSH).

Neni 5 Prona e shoqerise

1. Punonjesit duhet te mbrojne dhe ruajne pronen e Shoqerise, perfshire ketu edhe dokumentacionin shkresor dhe elektronik.
2. Punonjësit duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e mjeteve dhe pronës së Shoqerise.
3. Punonjesi nuk duhet te perdore ose te lejoje qe te perdoret prona qe shoqeria zoteron ose ka ne perdorim, per asnje qellim tjetër, perveçse per kryerjen e detyrave te percaktuara.
4. Punonjesit nuk duhet të përdorin mjetet apo pronen e Shoqerise për qëllime apo përdorim privat.

Neni 6 Ambienti i punes

1. Çdo punonjes duhet te sillet ne menyre profesionale dhe te respektueshme me koleget dhe eproret ne vendin e punes..
2. Sjellja e autoritetit superior ne menyre abuzive konsiderohen dhunim i ketij Kodi.
3. Nje ambient i tille sigurohet:
 - a. Kur ai eshte i drejte dhe i pershtatshem;
 - b. Kur eshte i sigurt dhe i jep mbeshtetjen punonjesit;
 - c. Kur nuk konsumohet alkool;
 - d. Kur nuk ka diskriminim ose dhunim;
 - e. Kur konsiderohen si vlera ndryshimet midis punonjesve dhe diversiteti i kulturave;
 - f. Kur informon ne menyre te paanshme punonjesit per rezultatet e tyre dhe i lejon te permiresohen;
 - g. Kur perpiqet te terheq pjesemarrjen e punonjesve ne vendimet qe merren;

4. Shoqeria duhet te angazhohet:
 - a. te siguroje nje ambient pune te shendetshem dhe te sigurt;
 - b. te zbatoje te gjitha politikat dhe rregullat per sigurine ne pune, rregulla qe kane te bejne me sigurine dhe shendetin ne vendin e punes;
 - c. te udhehiqet nga parimet e pergjithshme te trajtimit te barabarte te punonjesve, mbi parimin e profesionalizmit, te pavaresise dhe integritetit, te paanesise, te transparences, te vazhdimesise se karrieres, te pergjegjesise dhe korrektesise ne zbatimin e legjislacionit ne fuqi.

Neni 7 Drogat, alkooli, duhani

1. Ndalohet kategorikisht perdorimi, mbajtja apo tregtimi i substancave te quajtura "droge".
2. Ndalohet kategorisht konsumi i pijeve alkoolike, pasi ulin rendimentin ne pune, behen shkak per aksidente dhe ndikojne ne sjelljen e punonjesit duke demtuar imazhin e Shoqerise.
3. Ndalohet pirja e duhanit ne ambientet e zyrave dhe brenda te gjitha ambjenteve te tjera te OST sh.a,.
4. Ne zbatim te Ligjit nr.9636 dt. 06.11.2006 "Per mbrojtjen e shendetit nga produkteve te duhanit", i ndryshuar, personi pergjegjes per rastet e shkeljes per Zyrat Qendrore te OST sh.a eshte _____, ndersa per Njesite Operative dhe Njesine e Mirembatje te Transmetimit eshte Shefi i Njesise.
5. Per rastet e shkeljeve personi pergjegjes ka te drejte te propozoje ndeshkimin me masa disiplinore sipas procedures se percaktuar ne Kontraten Kolektive te OST sh.a.
6. Shkelja e ndalimit te pirjes se duhanit, ne zbatim te Ligjit nr.9636 dt. 06.11.2006 "Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit" i ndryshuar, kur nuk perben vepër penale, perben kundervajtje administrative dhe dënohet me gjobe.

Neni 8 Ngacmimi dhe abuzimi

1. Punonjesit OST sh.a nuk duhet te gjykojne e veprojne mbi baza diskriminuese (per arsye race, perkatesie fetare, gjinore, pozite sociale, orientim seksual, etj) si brenda dhe jashte ambienteve te punes.
2. Ngacmimi apo abuzimi, qofte racor, seksual apo cdo lloji tjeter eshte rreptesisht i ndaluar.
3. Çdo punonjes i OST sh.a ka te drejte per nje vend pune ku te ndjehet i lire dhe i

respektuar.

4. Cilido qe mendon se ka qene objekt i ndonje lloj ngacmimi mund ta raportoje ate prane DBNJSH.

Neni 9 Dhuna dhe armet

1. Shoqeria nuk duhet te toleroje dhunen ne vendin e punes.
2. Shoqeria pajtohet me politikat e qeverise qe kane te bejne me posedimin e armeve ne vendin e punes.

Neni 10 Perfitimi i dhuratave

1. Punonjesit e OST sh.a nuk duhet te kerkojne apo pranojne, per veten, familjen, te afermit apo per nje person tjeter, dhurata, favore, pritje apo çdo perfitim tjeter, te asnje lloji dhe vlere, qe ndikojne apo duket sikur ndikojne ne kryerjen e detyrave qe u jane caktuar.
2. Perjashtim behet ne rastin e ftesave te zakonshme, te mikpritjes tradicionale te dhuratave me vlere simbolike, te miresjelles te cilat nuk krijojne dyshime qe mund te ndikojne ne kryerjen e detyrave nga ana e punonjesit.

Neni 11 Pergjegjesite ndaj te treteve

1. Suksesit i Shoqerise varet nga reputacioni i saj per sherbimin, cilesine dhe integritetin. Menyra me te cilen punonjesit sillen me klientet, konkurrentet, furnizuesit, partneret ne biznes, komunitetin dhe punonjesit nderton besimin afatgjate dhe ne menyre absolute percakton suksesin e shoqerise.
2. Per kete duhet qe punonjesit:
 - a. Te veprojne me integritet (ndershmeri, korrektesi, drejtesi) ndaj klienteve partnereve ne biznes.
 - b. Te mos marrin hapa te padrejta nepermjet manipulimit ose shtremberimit te se vertetes se sherbimit.
 - c. Te sillen ne publik ne menyre etike.

Neni 12 Mbrojtja e personalitetit

1. Ky akt synon mbrojtjen e personalitetit te punonjesve nepermjet:

- a. Parandalimit të çdo qëndrimi që cenon dinjitetin e punonjesve;
- b. Ndalimit të çdo lloji shqetësimi seksual ndaj punonjesit dhe moslejimit të veprimeve të tilla nga punonjesit e tjerë;
- c. Ndalimit të dhënies ose marrjes së informacioneve për punonjesit, përveç atyre që lidhen dhe ndikojnë në proceset e punës apo në marrëdhëniet e punës dhe rasteve të cilat do të trajtohen sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar) dhe ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nepunesve publike" (i ndryshuar);
- d. Ndalimit për çfaredolloj arsye të cenimit të sendeve personale të punonjesit, përveç rasteve të perligjura.

Neni 13 Paraqitja e punonjesit

1. Veshja e punës e punonjesit ndryshon sipas rolit të tij në Shoqëri:
 - a. Punonjesit në Njesitë Operative dhe Njesinë e Mirembajtje të Transmetimit duhet të respektojnë modelet e veshjeve, të cilat jepen nga Shoqëria sipas Udhezimit për Veshjet e Punës.
 - b. Punonjesit, të cilët punojnë në zyrë, duhet të vishen në mënyrë formale, me një veshje të rregullt dhe me hijejnë:
 - o Punonjesit meshkuj, duhet të paraqiten me veshje klasike (nuk lejohen pantallona të shkurtera, pantofla etj).
 - o Punonjeshet femra, të paraqiten me veshje serioze (jo minifunde, dekolte ekstravagante etj).
 - o Të gjithë punonjesit, duhet të mbajnë në mënyrë të dukshme në ambientet e punës, Kartën zyrtare të identitetit me fotografi të punonjesit të OST sh.a.

Neni 14 Përdorimi dhe përhapja e informacioneve konfidenciale

1. Punonjesit kanë përgjegjësi:
 - a. Të mbrojnë sigurinë e çdo informacioni konfidencial, të OST sh.a.;
 - b. Të garantojnë mbrojtjen e informacionit që marrin dhe të mos e bëjnë atë publik pa autorizimin përkatës, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
 - c. Të ruajnë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës funksionale apo detyrës së ngarkuar dhe mos ta përdorin atë për përfitim personal, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e etikës;

- d. të marrin masa që të parandalojnë dhe të mbrojnë rrjedhjen e informacionit;
- e. Te mos përdorin marrjen dhe dënimin e informacionit, për përfitime të ndryshme ose kur përben shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punës;
- f. Te mos japin, publikojnë apo të nxjerrin për përdorim publik, materiale apo informacione që kanë të bëjnë me politikën ose me aktivitetet e OST sh.a., nëse nuk janë të autorizuar.

Neni 15 **Detyrimi i njohjes së të drejtave dhe detyrimeve**

1. Te gjithë punonjësit, duhet të njihen me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky Kod.
2. DBNJSH, duhet të bëjë të ditur punonjësit të administratës qendrore si dhe të gjithë punonjësit të Njësive, detyrimet që rrjedhin nga ky Kod dhe që duhet të respektohen.
3. Për çdo paqartësi në lidhje me këtë Kod, punonjësit duhet të drejtohen DBNJSH në Qendër.

Neni 16 **Raportimi**

1. Punonjësit duhet të raportojnë rastet e mosrespektimit të parimeve të etikës.
2. Menyra e raportimit do të jetë:
 - a. Punonjësi raporton tek Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve (DBNJSH), shkeljet e parimeve të etikës;
 - b. Procedura e trajtimit të raportimit duhet të jetë konfidenciale, ku sigurohet mbajtja e fshehtë dhe anonime e të dhënave personale, evitimi i hakmarrjes kundër çdo punonjësi, i cili në mirëbesim ngre çështje ose raporton dyshime për shkelje të këtij Kodi;
3. Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve (DBNJSH) ngarkohet për monitorimin dhe zbatimin e këtij Kodi.
4. Te gjithë punonjësit kanë përgjegjësinë për të qenë korrekt në zbatimin e ligjeve dhe parimeve të etikës, për t'u sjellë sipas standardeve të ndershmerisë, integritetit dhe paanshmerisë, për ta mbajtur lart efektivitetin e punës dhe figurën e shoqërisë si dhe për të rritur, forcuar besimin dhe mbështetjen e klientëve.
5. Në zhvillimin e aktivitetit të tyre të përditshëm, punonjësit e OST sh.a duhet të udhëhiqen nga dispozitat e Kodit të Punës dhe të këtij Kodi Etike.
6. Sjelljet që nuk janë përmendur në këtë kod, mund të konsiderohen gjithsesi si cenim i rregullave të etikës nëse vlerësohet se ndikojnë në reputacionin e Shoqërisë.

Neni 17
Masat disiplinore

Punonjesit qe shkelin parimet e etikes te percaktuara ne kete Kod, ndeshkohen me masa disiplinore sipas procedures se percaktuar ne Kontraten Kolektive te OST sh.a dhe akteve ligjore ne fuqi.

Ky Kod i Etikes hyn ne fuqi menjehere!

ADMINISTRATOR I OST SH.A

ENGJËLL ZEQQ

